



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo
Opština Štrpce
Komuna e Shtërpcës
Municipality of Strpce

Në mbështetje të neneve 12.2, pika (d), nenit 12.1, nenit 17 shkronja (b), nenit 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 5 paragrafi 1.2 nenparagrafi 1.2.1, nenit 6 paragrafi 1.2 nenparagrafi 1.2.1 dhe nenparagrafi 1.2.2, nenit 10 paragrafi 2 nenparagrafi 2.2 dhe nenparagrafi 2.2.1, nenin 11 dhe 15 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.30/2013) dhe Udhëzimit Administrativ MMPH– Nr. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale, Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr.08/2017 për normat teknike të Planifikimit Hapësinor dhe Vendimit për Dhënien e Pëlqimit për Miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Komunes se Shterpces 2025-2033 Njësia Org.Sp-02; me Nr.prot. 8116-2/25 dt. 08.12.2025 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nenit 10 shkronja b) dhe 34 shkronja m) të Statutit të komunës së Shtërpcës 01-Nr. 898 të datës 14.07.2010, si dhe Vleresimin e ligjshmerise se aktit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinore me Nr.prot. 2798-2/26 dt. 09.06.2026 me ane te se ciles ka kerkuar rishqyrtimin e Vendimin paraprak nr.01-020/08-4657/26 Per miratimin e Planit Zhvillimor Komunal, Kuvendi i Komunes se Shterpces ka ka rishqyrtuar aktin sipas kesaj kerkese dhe në Mbledhjen e rregullt të mbajtur me dt.10.06.2026 miratoi këtë:

VENDIM

Për miratimin e Planit Zhvillimor te Komunës së Shtërpcës 2026-2034

Neni 1

MIRATOHET Plani Zhvillimor i Komunës së Shterpces 2026-2034 për periudhën tetë (8) vjeçare, si një plan shumë-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor duke përfshirë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për tërë territorin e Komunës së Shterpces me sipërfaqe prej 24761 ha, 72 a, 95 m².

Neni 2

Plani zhvillimor Komunal i Shterpces 2026-2034 përcakton vizionin, parimet, objektivat dhe prioritetet e zhvillimit strategjik për tërë territorin e Komunës, mbi të cilat do të bazohet hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Shterpces.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi të Kuvendit është “Plani Zhvillimor Komunal i Shterpces 2026-2034” i hartuar nga Drejtoria e Per Planifikim, Rindertim, Urbanizem dhe Mbrojtje te Ambientit si bazë e procesit duke u bazuar në Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor “Gazeta Zyrtare

e Republikës së Kosovës Nr.30/2013”, Udhëzimin Administrativ MMPH – Nr.11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale, Udhëzimin Administrativ MMPH-Nr.08/2017 për normat teknike të Planifikimit Hapësinor dhe Vendimi për dhënien e pëlqimit për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Shterpces 2026-2034 njësia Org.Sp-02; me Nr.prot. 8116-2/25 dt. 08.12.2025 nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Neni 4

“Plani Zhvillimor Komunal i Shterpces 2026-2034” në vete përmban pjesën tekstuale dhe pjesën grafike, Vendimin për Pëlqimin Mjedisor për raportin e vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor të Komunës së Shterpces njës Org.Sp-02 me Nr.Prot. 248-2/21 Dt. 11.10.2022 dhe Raportin e Shqyrtimit Publik per PZHK 2025-2033 nr.06-150/02-10344/25 dt. 03.11.2025 të cilat po ashtu janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

Neni 5

Pas miratimit të këtij vendimi për zbatimin e tij do të kujdesen të gjitha organet e komunës së Shterpces nën mbikëqyrjen e Drejtorisë Per Planifikim, Rindertim, Urbanizem dhe Mbrojtje te Ambientit.

Neni 6

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi i Kuvendit Komunal me nr. protokolli 01-16-4499 Dt.28.12.2012 për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Shterpces 2012-2022+ .

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi (30) tridhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të MAPL-së dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Bojan Savic

